



Prishtinë, 29 gusht 2014  
Kodi i ZRRE-së: V\_644\_2014

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6, Nenin 25 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Vendimin nr.V\_631\_2014 për të Hyrat E Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar);
- Vendimin e KOSTT nr. 633\_2014 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A (KOSTT);
- Vendimin e OSSH nr.634\_2014 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);dhe
- Vendimin e Furnizuesit Publik (KEDS)nr. 635\_2014 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i licencuar si Furnizuesi Publik me energji elektrike (KEDS);dhe
- Kërkesën e KEDS të dorëzuar me datën 4 gusht 2014 për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm pas shpërthimit në TC Kosova A me dokumentacionin relevant sqarues.



Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 29 Gusht 2014 nxori këtë:**

## V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mbliidhen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të aplikohen nga **Furnizuesi Publik me energji Elektrike (KEDS)**, për vitin rregullativ tarifor 2014 (prill 2014-mars 2015). Ky vendim do të zbatohet nga 1 shtator 2014 dhe zgjatë deri në shqyrtimin tjetër të rregullt tarifor.

## ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datën 4 gusht 2014 ka pranuar nga KEDS-Divizioni i Furnizimit Kërkesën për shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Të Hyrave të Lejuara Maksimale, që Furnizuesi Publik lejohet të mbledhë nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- ✚ Me rastin e vendosjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbuloohen nga Furnizuesi Publik, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
- Vlerësimi përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Vlerësimi përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Raporti përfundimtar- Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 Qershor 2014; dhe
  - Raporti përfundimtar -Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPPE), i publikuar më datën 24 Qershor 2014;
  - Raporti Konsultativ- Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8- Vlerësimi i ndikimit në të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe rishqyrtimi tarifor, i publikuar më datën 13 Gusht 2014;
  - Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i Tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8 - Përgjigjet në komente, i publikuar më datën 28 Gusht 2014.
  - Gjatë periudhës 13 gusht –26 gusht 2014, ZRRE ka mbajtur takime dhe konsultime të shumta lidhur me shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8;
- II.** Duke marrur parasyshë dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave relevante, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III.** Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik që mbuloohen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për vitin relevant tarifor SHTE 8 pas shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike do të jenë 252,389,459 euro. Vlerësimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale janë të paraqitura në Raportin Konsultativ - Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i tarifave të energjisë




elektrike në kuadër të SHTE8 - Vlerësimi i ndikimit në të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe rishqyrtimi tarifor dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.


- IV. Ky vendim modifikon vendimin V\_635\_2014 për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) që do të zbatohet nga Furnizuesi Publik me Energji Elektrike, vendimet 631\_2014, 633\_2014 dhe 634\_2014 mbesin në fuqi.
- V. Për qëllime të shqyrtimeve të rregullta tarifore ky vendim do të vlerësohet së bashku me vendimet e MAR-eve e të gjithë të licencuarve tjerë. Çdo ndryshim në të Hyra që rezulton nga ky Shqyrtim i Jashtzakonshëm në krahasim me të hyrat e lejuara maksimale nga ZRRE për vitin rregullativ 2014 për secilin të licencuar, në këtë rast KEK, KOSTT, OSSH dhe FPEE do të analizohen dhe sipas vlerësimeve edhe do të kompensohen në Azhurnimin Vjetor të radhës dhe në Përshtatjet e Rregullta të vitit rregullativ 2015.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeve në mes të versioneve të përkthyer , do të mbizotëroj versionin në gjuhën shqipe.
- VII. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga Furnizuesi Publik duke filluar nga 1 shtator 2014 deri në shqyrtimin e rregullt dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

  
Enver Halimi, Kryesues

  
Merita Kostari, Anëtar

  
Krenar Bujupi, Anëtar